

VENDIM
Nr. 60, datë 6.2.2023

**PËR DËRGIM PERSONELI ME MISION HUMANITAR NË TURQI, NË
MBËSHTETJE TË AUTORITETEVE TURKE PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS
SË KRIJUAR NGA TËRMETI I DATËS 6 SHKURT 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e personelit, të përbërë nga 53 (pesëdhjetë e tre) veta, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes me mision humanitar, në Turqi.

2. Misioni i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes është mbështetja e autoriteteve turke, që menaxhojnë dhe drejtojnë operacionet e përballimit të situatës së krijuar nga tërmeti i datës 6 shkurt 2023, zhvillimi i operacioneve të kërkim-shpëtimit në ambiente urbane (USAR), si dhe dhënia e ndihmës mjekësore të menjëhershme.

3. Venddislokimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes është në Gaziantep, Turqi.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni humanitar është deri në 3 (tre) muaj. Periudha e qëndrimit fillon të llogaritet nga data e nisjes së personelit në mision.

5. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës në këtë mision, përballon shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit në mision, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) akomodim;

c) ushqim;

ç) ujë të pijshëm;

d) energji elektrike;

dh) lavanderi;

e) sigurim jete;

ë) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

f) mbështetje shëndetësore;

g) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

gj) transport;

h) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

i) shpenzime të tjera për mbarëvajtjen e kryerjes së misionit.

6. Transporti i personelit, që merr pjesë në misionin në Turqi, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, uji, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2023.

8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama